

**SHKURT**

## USAID ndihmon të rinjtë për punësim profesional

**PRISHTINË, 2 NËNTOR** - Mbështetja e USAID-it ofruar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit ka rezultuar me punësimin profesional të 75 të rinjve.

Drejtor i KPEP-it, Mark Wood, ka thënë se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës. "Për t'iu ofruar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës", ka shtuar Wood.

Trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot 59 studentëve u janë vazhduar kontratat.

Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service - Austria (WUS - Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani dy prej tyre u është ofruar mundësi punësimi permanent.

Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumështit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë fillestarë dhe 5 mentorë, të cilët ishin zgjedhur nga pilotgrupi i programit të vitit 2009. Programi prapë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar.

Ka pasur programe dhe trajnime të tjera.

**USAID**

